



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:245398
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05522436

Ac.nr.914/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. B., adresa: fshati Qylagë, Komuna Lipjan, përfaqësuar nga M. S., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigma” me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Y. M., objekti i kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1031/15, i datës 12.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit H. B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.174/18, datë 12.11.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.174/18, i datës 12.011.2021, ka vendosur si në vijim: APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadija e paditësit H. B. nga Prishtina, dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigma”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, t’ia paguaj shumën e mjeteve si në vijim: për dhimbje fizike shumën prej 1,100€, për frikën e përjetuar shumën prej 900€, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 150€, për ushqim të përforcuar shumën prej 150€, për shpenzime të mjekimit shumën prej 35.18€, në shumë të përgjithshme prej 2,335.18 €, me kamatë ligjore prej 8%, ashtu që për dëmin jo material kamata do të filloj të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimit me dt.12.11.2021 e deri në pagesën e tërësishme, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të kërkesës për kompensim me dt.24.12.2014 e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij

aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm. Ndërsa në pikën e dytë të dispozitivit ka vendosur të REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë, mbi shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 2,400.00€; për frikën e përjetuar shumë prej 1,600.00€, në emër të rehabilitimit klimaterik dhe fizioterapeutik shumë e tërësishme prej 200€. Kurse në Pikën tre është vendosur të DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës civile në shumë prej 634.40 €, në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për sa i përket lartësisë së kompensimit.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala e paditur ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të tij me datë 29.04.2015 ka paraqitur padi për kompensim dëmi, të shkaktuar lidhur me aksidentin e datës 29.04.2015, kundër të paditurës për shkak se ishte shkaktuar fatkeqësi e komunikacionit, ashtu që e paditësi në cilësinë e këmbësorit ka pësuar lëndime trupore. Ai ka paraqitur se si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar dhimbje fizike, frikë, nevojë për ushqim të përforcuar, ndihmë dhe përkujdesje e huaj, shpenzime të mjekimit. Përmes përfaqësuesit të tij, ai ka bërë rregullimin e padisë në kuptimin objektiv, tanimë duke kërkuar për secilën kategori dëmi, shumë të caktuar kompensimi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se nga provat e administruara Gjykata erdhi në përfundim se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, respektivisht përgjegjësia e palëve për dëmin e shkaktuar. Sepse palët në shqyrtimin gjyqësor por edhe e paditura në përgjigje në padi e ka marrë përsipër përgjegjësinë për 80% të kontributit të saj në shkaktimin e dëmit. Andaj kontestuese ishte vetëm lartësia e shumave të kompensimit. Më tej ka arsyetuar se nga ekspertizat mjekësore gjykata ka vërtetuar se paditësi H. B. si pasojë e aksidentit të komunikacionit ka pësuar: Ndrydhje në regjionin e kokës dhe qafës, ndrydhje në regjionin e gjoksit, regjionit L/S dhe gjurit të majtë. Ekspertët përkatës, pas analizimit të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit, kanë ardhur në përfundim se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Gjykata në emër të dhimbjeve fizike e aprovoi kërkesën në shumë prej 1,100 €, të cilën e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të kompensimit të dëmit të pësuar jo material. Për pjesën e frikës, gjykata ka arsyetuar se sipas ekspertit të psikiatrisë, paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur rreth 1 orë kohë e nevojshme për marrjen e ndihmës së parë në Qendrën Emergjente në Prishtinë, e cila është manifestuar në formë të konfuzionit, të brengës për paraqitjen e pasojave se mos po mbetet i palëvizshëm dhe nuk do të jetë plotësisht i pavarur. Më tej eksperti ka konstatuar

se paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth 4 muaj. Kjo frikë është manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja për shkak të lëvizjeve të kufizuara (mbajtja e splinit të gjurit), duke i shkaktuar pengesa në realizimin e aktiviteteve të përditshme e që në aspektin psikik i kanë shkaktuar ankth, pagjumësi, dridhje të trupit. Paditësi ka pasur edhe frikë e intensitetit të ulët për rreth 12 muaj, herë pas here ka pasur nervoz dhe pagjumësi në formë të zgjimeve të shpeshta gjatë natës dhe rikujtim të ngjarjes. Prandaj shpërblimi në shumë prej 900€ si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të kompensimit. Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata ka arsyetuar se kompensimi përtej shumave të gjykuara, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të jetë i drejtë. Ndërsa sa i përket kërkesës për rehabilitim klimaterik Gjykata e refuzoi në mungesë të provave materiale. Vendimi për kamatën është marrë konform neni 382 të LMD-së, kurse vendimi për shpenzime, sipas neni 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së neni 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk është lëshua në analizë më të zgjeruar sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, për ndërgjyqësit nuk ishte kontestuese ndarja e përgjegjësisë në ngjarjen e shkaktuar, pra për këtë janë pajtuar, gjithashtu nuk kishte pretendim ankimor për këtë pjesë.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për themelësinë e kërkesëpadisë, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë e ka është provuar përmes ekspertizave mjekësore, lëndimin dhe pasojat për paditësin, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara, për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësi.

Si rrjedhojë e vërtetimit të gjendjes faktike dhe peshimit të duhur të fakteve dhe provave, gjykata ka arritur që gjendjen faktike të kualifikoj drejtë në normat materiale të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Pretendimet e palës paditëse për sa i përket fakteve të ngritura se shumata e kompensimit që është njohur nga gjykata e shkallës së parë, nuk është në harmoni me natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, kjo gjykatë i gjeti si të pa bazuara, kjo ngase ndërgjyqësit ishin pajtuar për sa i përket faktit të ndarjes së përgjegjësisë, pra e paditura është mbajtur përgjegjëse për të siguruarin në lartësi prej 80%, rrethanë e cila duhet të konsiderohet në shumata e gjithmbarshme të kompensimit. Po ashtu, bazuar në ekspertimin e bërë, është arritur të provohet se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pësuar lëndime të lehta trupore. Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, në nenin

183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se *Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i*

frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate, bazuar në këtë dispozitë ligjore, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e lëndimeve trupore të shkaktuara për paditësin, vlerësimit në ekspertizave mjekësore, pranoi qëndrimin e shkallës së parë për sa i përket caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Për sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë që ka të bëjë me kompensimin në emër të dëmit material për kujdesin nga personi tjetër dhe ushqimit të përforcuar, Gjykata Apelit vlerësoi se shumatat e gjykuara janë reale dhe në përputhje me kohëzgjatjen nevojës për përkujdesjen e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësin.

Gjykata e shkallës së parë për shumatat e gjykuara ka caktuar kamatën e cila për dëmin jo material fillon të rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të kërkesës për kompensim, gjë që është në pajtim me të drejtën materiale në këtë rast nenit 382 të LMD –së.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.914/2022, datë 27.03.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli